

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5618
E premte, 2 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Qeveria rrit për 12 për qind buxhetin për arsim | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**BARDHYL MAHMUTI E FTON
DICK MARTYN NË
BALLAFAQIM PUBLIK** F. 13

**PJESËTARËT E FSK-SË
MARSHOJNË NË KUJTIM TË
RRUGËS SË BETEJAVE TË
FEHMI DHE XHEVË
LLADROVCIT** F. 5

**OKUK-ja BËHET ME 300
SHTRETËR TË RINJ** F. 6

EKONOMI

**KOSOVA KA POTENCIALE TË
MËDHA TË ENERGJISË
SOLARE DHE ASAJ TË ERËS** F. 9

**BIZNESET TURKE,
TË INTERESUARA TË
INVESTOJNË NË KOSOVË** F. 9

KULTURË

**PUNONJËSIT E
INSTITUCIONEVE TË
KULTURËS DHE TË
TRASHËGIMISË MARRIN
PAGAT ME RITJE
50 PËR QIND** F. 13

SPORT

**GJYSMA E SUPERLIGËS
NDËRROJNË TRAJNERËT** F. 15

**'EPOKA E RE' - 'LAJMI.NET',
DERBI I MEDIA LIGËS** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARTAN MURATI | FAQE 4-5

Zhvillimet në Kuvend po e vështirësojnë arritjen e konsensusit

Menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka vlerësuar se në këtë institucion po bëhet lojë puro politike. Ai ka thënë se partitë politike kanë qasje diametralisht kundërta sa i përket përfaqësimit të shtetit në dialogun e Brukselit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se zhvillimet e fundit në

Kuvend po e vështirësojnë arritjen e konsensusit. Ai ka theksuar se pas mosmiratimit të rezolutës opozita mund t'i bojkotojë seancat dhe, sipas Muratit, ky është një lajm i keq për Kuvendin dhe jetën legislative. Ai u ka bërë thirrje subjekteve politike që të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të Kuvendit për dialogun me Serbinë



MBAHET KONFERENCA E NËNTË "FSK-JA DHE PARTNERËT"

Tranzicioni i FSK-së, proces i pandalshëm



Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë me dije se tranzicioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri është proces i pandalshëm, i domosdoshëm dhe në interes të të gjithëve në Kosovë dhe në rajon. Në konferencën "FSK-ja dhe partnerët",

Veseli dhe Haradinaj kanë thënë të premtën se ky tranzicion do ta ruajë edhe karakterin shumetnik të FSK-së pasi, sipas tyre, kjo forcë ka përmbushur të gjitha standardet e nevojshme për të kaluar në hapin tjetër të saj: formalizimin në ushtri të Kosovës | FAQE 7

Rezoluta e LDK-së për dialogun me Serbinë nuk kalon në Kuvend

 | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Edita Tahiri kundërshton idenë për ndryshim të kufijve

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet teknike me Serbinë, Edita Tahiri ka thënë se pozicioni i Gjermanisë kundër ndryshimit të kufijve në Ballkanin

Perëndimor mbështetet gjerësisht nga Kosova. Sipas saj, ndryshimet e kufijve sjellin paqëndrueshmëri dhe luftëra të reja. "Pozicioni i Gjermanisë kundër

ndryshimit të kufijve në Ballkanin Perëndimor mbështetet gjerësisht nga Kosova. Ajo ruan paqen, parimet e BE-së dhe të ardhmen evropiane të gjashtë shteteve të

Ballkanit Perëndimor duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Ndryshimet e kufijve sjellin paqëndrueshmëri dhe luftëra të reja", ka shkruar Edita Tahiri në Twitter.



Opozitës maqedonase i ikin 12 deputetë, forcohet blloku për marrëveshjen me Greqinë

Nga partia VMRO-DPMNE ishin përjashtuar 8 deputetë të cilët mbështetën ndryshimet kushtetuese, por të pakënaqur me këtë vendim si dhe me qasjen e partisë ndaj procesit me marrëveshjen me Greqinë, janë larguar edhe katër të tjerë

SHKUP, 1 NËNTOR - Ka shkuar në 12 numri i deputetëve që janë larguar nga koalicioni opozitar i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, i cili nga 51 deputetë sa kishte ka mbetur me 39.

Fillimisht nga partia ishin përjashtuar 8 deputetë të cilët mbështetën ndryshimet kushtetuese, por të pakënaqur me këtë vendim si dhe me qasjen e partisë ndaj procesit me marrëveshjen me Greqinë, janë larguar edhe katër të tjerë.

Nga VMRO-ja për këtë kanë akuzuar partinë në pushtet se "me kërcënime e shantazhe të ulëta kanë marrë mbështetjen për marrëveshjen kapitulluese". Por, deputetët e përjashtuar dhe

ata të larguar, kanë denoncuar kërcënime të ndryshme, që sipas tyre kanë ardhur nga struktura të ndryshme. Disa prej tyre tashmë po ruhen nga policia, ndërsa kanë nisur edhe procedura gjyqësore që konfirmohet edhe nga ministrja e Drejtësisë, Renata Daskoska.

"Ata që shkruanin nekrologji dhe i ngjitnin para dyerve të LSDM-së, tani kërcënojnë deputetët e VMRO-DPMNE-së, që votuan për ndryshimet kushtetuese. Këta nuk janë individë, por një grup mirë i organizuar. Kemi dëgjuar për kërcënime ndaj nënkryetarit të përjashtuar të VMRO-së. Këto kërcënime jo vetëm që duhet të



procedohen nga institucionet, por edhe të debatohet për to në opinion, pasi krijojnë një atmosferë të keqe", ka deklaruar Daskoska, ndërkohë organet e hetuesisë kanë urdhëruar ngrirjen e pasurisë së VMRO-së, respektivisht të 69 objekteve të cilat nuk do të mundet të shiten

apo jepen me qira, për shkak të dyshimeve për keqpërdorime financiare.

Për zhvillimet në VMRO, disa nga ish-anëtarët e saj akuzojnë kreun e partisë, Hristijan Mickovski se interesat shtetëror i ka vendosur mbi ato partiake, ndërsa kërkojnë mbajtjen e një

kongresit të jashtëzakonshëm. Duke komentuar zhvillimet në VMRO-DPMNE, Alajadin Demiri, njohës i çështjeve politike, thotë se në këtë parti janë duke ndodhur zhvillime të rëndësishme mes dy rrymave mbi të ardhmen e maqedonasve, njëra që mbron teorinë e ish-kryetarit Nikolla Gruevski mbi prejardhjen antike të maqedonasve dhe e grupit tjetër që sipas tij e ka kuptuar këtë mashtrim të Gruevskit dhe tenton të kthehet në realitet. VMRO-DPMNE-ja ka qeverisur në dhjetë vjetët e fundit në Maqedoni me në krye Nikolla Gruevskin, i cili tani po gjykohej në disa procese gjyqësore për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Procese po zhvillohen edhe ndaj personaliteteve tjera të larta të kësaj partie, e cila kundërshtoi fuqishëm Marrëveshjen me Greqinë për zgjidhjen e kontestit 27-vjeçar për emrin e shtetit.

Bashkëpunimi ndër-kufitar Shqipëri-Mal i Zi



TIRANË, 1 NËNTOR - Shqipëria dhe Mali i Zi do të kenë një tjetër lidhje transporti mes tyre. Bëhet fjalë për transportin liqenor në Liqenin e Shkodrës, përmes molit të Zogajt e Shirokës në Shkodër dhe Virpazarit në anën e Malit të Zi.

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, gjatë fjalës së tij në Kuvend bëri të ditur gjithashtu se do të ketë dhe një linjë transporti multimodal mes Shqipërisë, Italisë dhe Malit të Zi, përmes Portit të Barit, të Shëngjinit dhe atij të Barit në Malin e Zi.

"Kemi rënë dakord në kuadër të

programit trepalësh Shqipëri-Mali i Zi- Itali, që mbështetet nga fondet e BE-së për një projekt rreth 7 milionë euro, i cili do të ketë dy objektiva specifike: E para, vendosjen e një linje transporti multimodal mes Portit të Barit, portit të Shëngjinit dhe Portit të Barit në Malin e Zi, sepse bëhet fjalë për hapësirën adriatike dhe ndër lidhjen me liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna. Dhe së dyti, vendosjen e një transporti liqenor nëpërmjet molit të Virpazarit në Malin e Zi, në molin e Zogajt, Shirokës për të krijuar një mundësi që liqeni të jetë gjithashtu më i rivital-

izuar sesa është sot për sot", tha ai.

Bushati tha se ky është një projekt, i cili fillimisht do të fokusohet vetëm te transporti i udhëtarëve për t'u krijuar mundësi qytetarëve për të lëvizur më shpejt, në mënyrë më komode dhe nga ana tjetër për t'u krijuar mundësi vizitorëve të huaj për të pasur turizmin ditor, qoftë në Malin e Zi apo në Shkodër në pjesën e liqenit. Perspektiva tha ai, është që në fazën e dytë dhe të tretë kjo do të shkojë dhe në pjesë që kanë lidhje me Shëngjinit, Velipojën dhe lumin Buna.

Vuçiq thotë se ka informacione për vrasje në Pejë më 1998

BEOGRAD, 1 NËNTOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka thënë se ka informacione dhe njohuri për vrasjen e gjashtë serbëve në Pejë në vitin 1998, për të cilën gjë, siç ka thënë ai, askush nuk është përgjigjur.

Më 14 dhjetor 1998, dy persona të maskuar kanë hyrë në kafenenë "Panda" dhe kanë vrarë nxënësit e shkollave të mesme: Ivan Obradović, Zoran Stanojević, Svetislav Ristić, Dragan Trifović, Vukosav

Gvozdenović si dhe studentin, Ivan Radović.

"Kam informacione dhe njohuri, por autoritetet tona përgjegjëse janë në kërkim të dëshmitarëve të plotë që ky krim i tmerrshëm të zgjidhet. Sa i përket Serbisë dhe

mua personalisht, prindërit e viktimitave mund të jenë absolutisht të bindur se nuk do ta fshehim të vërtetën pavarësisht se kush është ai që ka marrë pjesë në këtë krim të rëndë, qoftë shqiptar apo serb", ka thënë Vuçiqi.



Rezoluta e LDK-së për dialogun me Serbinë nuk kalon në Kuvend

Partitë politike në pushtet dhe ato në opozitë nuk kanë arritur ta harmonizojnë tekstin e rezolutës për kornizat e dialogut me Serbinë. Kuvendi hodhi në votim rezolutën e LDK-së e cila nuk mori më shumë se 50 vota. Menjëherë pas këtij rezultati të votimit, partitë opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosje, e kanë lëshuar sallën e Kuvendit



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Partitë politike në pushtet dhe ato në opozitë nuk kanë arritur ta harmonizojnë tekstin e rezolutës për kornizat e dialogut me Serbinë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kishin para vetes një rezolutë të propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe gjashtë pika të propozuara nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Rezoluta e propozuar nga partia opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkon që presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, të mos i lejohet të negociojë me Serbinë çështjen e kufijve të Kosovës. Të njëjtës rezolutë Partia Demokratike e Kosovës kërkoi t'i shtohen edhe gjashtë

pika.

Bazuar në qëndrimet e ndryshme, Kuvendi mori një pauzë duke u dhënë rast grupeve parlamentare që ta harmonizojnë tekstin. Por, pas vazhdimit të seancës, shefat e grupeve parlamentare, Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Memli Krasniqi nga Partia Demokratike e Kosovës, konfirmuan se nuk kanë arritur marrëveshje për harmonizimin e tekstit. Votimi në Kuvend ka sjellë si rezultat 50 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Ky numër i votave nuk ka mjaftuar që rezoluta e propozuar nga LDK-ja të miratohet. Menjëherë pas votimit, partitë opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosja, kanë lëshuar sallën e Kuvendit. Shefi i grupit parlamentar i

LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se koalicioni qeverisës nuk e ka votuar rezolutën për dialogun pasi, sipas tij, nëse do të kalonte kjo rezolutë, do të binte Qeveria. "Ose votohet rezoluta që e ndalon Thaçin dhe këdo tjetër të negociojë për kufijtë, ose bie Qeveria. Kjo është arsyeja pse disa parti të koalicionit PAN nuk e votuan rezolutën. Ndryshe nuk ka kuptim refuzimi i tyre,

pasi në deklarata janë të zëshëm kundër negociimit të kufijve", ka thënë Hoti.

Por shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, e refuzoi këtë formulim. "U takuam dhe them me keqardhje që nuk pati vullnet të kemi pajtim", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se propozuesi i rezolutës ka insistuar që ajo ta ketë vetëm një pikë. "Nuk heqim dorë dhe nuk

dorëzohemi nga kërkesa dhe insistimi ynë që, nëse jo sot, në ditët e ardhshme të mblidhemi dhe ta krijojmë një qëndrim. Nuk do të marrim pjesë fare në votim sepse ky është kurth absolutisht i padrejtë, në të cilin po mendon propozuesi ta fusë koalicionin, po ne nuk do të biem në të", ka thënë Krasniqi para se të hidhej në votim rezoluta e LDK-së.

Qeveria rrit për 12 për qind buxhetin për arsim



PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - "Qeveria, e cila jep më shumë buxhet për arsim, do të thotë që e ka me rëndësi atë", kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të enjten në një ngjarje publike me moton "Roli i prindërve në arsimimin e fëmijëve", organizuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) dhe GIZ-i. Haradinaj ka treguar se para disa muajsh nga një grup fëmijësh pati marrë një peticion, ku kërkohej që arsimi të vendoset prioritet. Sipas kryeministrit, arsyeja që i ka bërë sot bashkë është roli i prindërve në arsimimin e fëmijëve dhe fushata për "Arsim më të mirë në Kosovë". Sipas kryeministrit Haradinaj, lajmi i parë është se për një arsim të mirë duhen respektuar profesorët, pedagogët, edukatorët, prandaj me Ligjin për paga ata respektohen shumë, por prapë jo sa duhet, duke ditur se ata meritojnë shumë. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se arsimi është vendosur si një nga prioritetet kryesore të jetës dhe si vërtetohet edhe nga fakti, sepse buxheti i vitit që vjen parasheh shumën prej 300 milionë eurosh dedikuar arsimit,

pra 12 për qind më shumë se në vitin që po e lëmë. "Qeveria, e cila jep më shumë buxhet për arsim, do të thotë se e ka me rëndësi atë", është shprehur ai, duke shtuar se njëkohësisht është rritur edhe buxheti nëpër komuna dedikuar arsimit në vlerë 185 milionë euro dhe kështu ato kanë 14 milionë më shumë se këtë vit. Haradinaj ka falënderuar të gjithë ata që po kontribuojnë për ngritjen e cilësisë në arsim, veçanërisht nxënësit që kanë bërë peticionin, organizatën GIZ, si dhe Bashkimin Evropian dhe UNICEF-in, duke iu uruar sukses. Ndërkaq ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka theksuar se është bërë një punë shumë e mirë gjatë kësaj fushate për arsimim më të mirë dhe se duhet bërë gjithçka për fëmijët e Kosovës. Kurse Boris Scharlowski, përfaqësues i GIZ-it, udhëheqës i projektit "Ngritja e kapaciteteve në arsimin fillor", ka thënë se sot po festohet përvjetori i fushatës për "Arsim më të mirë në Kosovë", për ngritjen e arsimit si prioritet kryesor, ngaqë kjo ka të bëjë me perspektivën dhe të ardhmen e fëmijëve.

Flet për "Epokën e re", Artan Murati

Zhvillimet në Kuvend po e vësht



Menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka vlerësuar se në këtë institucion po bëhet lojë puro politike. Ai ka thënë se partitë politike kanë qasje diametralisht të kundërta sa i përket përfaqësimit të shtetit në dialogun e Brukselit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se zhvillimet e fundit në Kuvend po e vështirësojnë arritjen e konsensusit. Ai ka theksuar se pas mosmiratimit të rezolutës opozita mund t'i bojkotojë seancat dhe, sipas Muratit, ky është një lajm i keq për Kuvendin dhe jetën legjislative. Ai u ka bërë thirrje subjekteve politike që të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të Kuvendit për dialogun me Serbinë

"Epoka e re": Duke i pasur parasysh këto qëndrime të kundërta në mes të pozitës dhe opozitës, në ditët në vazhdim mund të thirret sërish një seancë për çështjen e kësaj rezolute?

Murati: Do të ketë tentativa për mbajtjen e ndonjë seance të re ku do të flitej për çështjen e dialogut, mirëpo është krijuar një klimë tjetër politike me që subjektet politike opozitare mosmiratimin e rezolutës do ta shohin si një përpjekje të tyre të dështuar për të bërë diçka më tepër në Kuvend dhe një minim tjetër të punës së opozitës prej koalicionit qeverisës. Pra, do të jetë e vështirë që të binden dhe t'u kthehen diskutimeve. Prandaj çdoherë e më tepër po vështirësohet arritja e konsensusit duke i pasur parasysh veprimet që po ndodhin në Kuvendin e Kosovës.

"Epoka e re": Gjatë kësaj seance dëgjua deputetë të koalicionit të cilët në një farë mënyre e akuzonin opozitën e cila, sipas tyre, nuk është e interesuar për aprovimin e rezolutës.

Murati: Atë që po kërkojnë deputetët e koalicionit qeverisës, pra që të përfshihet gjithçka brenda një rezolute, është një qasje ambicioze duke pasur parasysh klimën politike ekzistuese. Për këtë qeveria do të ishte dashur që ta miratonte një platformë qeverisëse për dialogun, gjë që ka tentuar ta bëjë më herët, por e ka tërhequr për shkak se ka qenë e dobët platforma. Mirëpo të enjten grupet parlamentare është dashur t'i gjejnë pikat e përbashkëta sepse ka pika të përbashkëta ku pajtohen të gjithë dhe të shkonin me një

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 NËNTOR -

"Epoka e re": Z. Murati, as të enjten Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta miratojë rezolutën për dialogun të propozuar nga partitë opozitare.

Murati: Është lojë puro politike që po bëhet në Kuvendin e

Kosovës. Po shohim se partitë politike kanë qasje diametralisht të kundërta sa i përket përfaqësimit të shtetit në dialogun e Brukselit. Si molla sherri doli të jetë prapë çështja se kush duhet ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces. Subjektet opozitare, sidomos LDK-ja dhe Vetëvendosja, kërkojnë që me rezolutë ta

kufizojnë mandatin e presidentit Thaçi në dialog, por kjo është e papranueshme për PDK-në dhe partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës. Si pasojë e kësaj kemi një Kuvend i cili po dështon tash e sa kohë që të miratojë një rezolutë me anë të së cilës do ta paraqiste pozicionin e vet karshi procesit të dialogut.

irësojnë arritjen e konsensusit

enjtës. Kemi qasje të ndryshme, opozita kërkon zgjedhje, por subjektet në pushtet dëshirojnë t'ia zgjasin jetën kësaj legjislature. Si duket koncentrimi i madh për zgjedhje po ndikon që subjektet politike të mos mund të bashkëpunojnë dhe të mos e japin më të mirën e tyre, madje as opozita nuk është e bashkuar në këtë drejtim.

"Epoka e re": Pas dështimit të rezolutës, mund ta bojkotojë opozita Kuvendin?

Murati: Se do të ketë bojkot të seancave të Kuvendit u pa qysh kur rezoluta nuk i mori votat e mjaftueshme. LDK-ja dhe Vetëvendosja lëshuan sallën ndonëse ishte thirrur vazhdimi i seancës me pika nga seancat paraprake. Me siguri se do të ketë bojkot të mëtutjeshëm dhe ky është një lajm i keq për Kuvendin dhe jetën legjislative.

"Epoka e re": Pas këtyre zhvillimeve, si e shihni funksionimin e Kuvendit?

Murati: Kuvendi është kaotik, nuk ka funksionim të rregullt të punës, madje edhe kryesia po ndikon shumë në këtë kaos meqë nuk ka pasur mbledhje të rregullta duke lejuar që të grumbullohen shumë pika të rendit të ditës. Për të funksionuar Kuvendi në të ardhmen si duhet, koalicioni qeverisës duhet ta garantojë shumicën parlamentare. Koalicioni qeverisës duhet t'i sigurojë numrat për të vazhduar më tutje meqë nuk mund të pritët prej opozitës që të bëjë kuorumin sepse nuk e ka obligim, ndonëse pjesëmarrja e deputetëve në punimet e Kuvendit është obliguese. Në aspektin politik opozita ka të drejtë mos të marrë pjesë në seanca, mirëpo kjo nuk duhet të përkthehet në dështim të seancave. Shumica parlamentare duhet të ekzistojë dhe të vazhdojë agjenda e paraparë. Në të kaluarën, pavarësisht prek pjesëmarrjes së opozitës, sidomos të PSD-së, kanë dështuar seancat në mungesë të kuorumit, që del se nuk ka vullnet dhe koncentrim të mjaftueshëm as të koalicionit qeverisës në punën e Kuvendit. Koalicioni përbëhet edhe prej Listës Serbe, por nuk mund të llogaritet se votat e saj do të jenë të rregullta dhe se Kuvendi do të funksionojë normalisht.

"Epoka e re": Ky mosfunksionim i Kuvendi është duke u paraprirë zgjedhjeve të reja?

Murati: Tendencat për zgjedhje janë evidente, sidomos prej subjekteve në opozitë. Deri më

tani nuk ka asnjë veprim konkret që mund ta çonte vendin në zgjedhje. Opozita nuk i ka numrat e mjaftueshëm për ta rrëzuar Qeverinë dhe, si duket, brenda koalicionit qeverisës nuk ka disponim për ta prishur koalicionin, sepse nga e kaluara kemi parë se çdoherë ka qenë një subjekt i koalicionit që ka përkrahur mocionet e mosbesimit ndaj Qeverisë. Ndonëse ka narrativ të vazhdueshëm për zgjedhje në praktikë, nuk ka ndonjë veprim konkret. Ka qenë vetëm PSD-ja që publikisht ka ofruar nënshkrimet për rrëzimin e Qeverisë.

"Epoka e re": Më 9 nëntor është paralajmëruar takimi i radhës në kuadër të dialogut të Brukselit. Si e shihni vazhdimin e këtij procesi pa miratimin e rezolutës?

Murati: Ka rrezik permanent që dialogu të vazhdojë me këta aktorët e mocëm, pastaj të arrihet një marrëveshje pa një pozicion të Kuvendit dhe në fund ajo marrëveshje të tentohet të ratifikohet. Por, pa opozitën nuk ka shans të bëhet ratifikimi i asnjë lloji marrëveshje dhe kësaj mund të përsëritet skenari i marrëveshjes së demarkacionit, ku Kosova

Subjektet politike të fokusohen në pikat e përbashkëta

"Epoka e re": Cilat janë rekomandimet e KDI-së për daljen nga kjo situatë?

Murati: Në vazhdimësi KDI-ja bën thirrje për konsensus në mes të subjekteve politike, ofron rekomandime të ndryshme, si dhe shpeshherë ofron platforma për diskutim në mes të subjekteve politike. U bëjmë thirrje subjekteve politike që të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në

bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të Kuvendit për dialogun. Bëjmë thirrje që dialogu t'i kthehet Kuvendit dhe Kuvendi të ketë rol qendror në këtë proces. Duhet të sigurohet transparencë dhe llogaridhënia e procesit në mënyrë që deputetët të dinë se çfarë po ndodh në Bruksel dhe të dinë se për çfarë marrëveshje eventuale do të votojnë.

humbi disa vjet dhe tani po shihet se çfarë ka ndodhur me procesin e liberalizimit. Kjo do të ishte shumë negative sepse nëse arrihet një marrëveshje e cila do të ratifikohet në Serbi e jo në Kosovë, BE-ja assesi nuk do ta presë Kosovën për shkak të problemeve të brendshme politike dhe nuk do ta pengonte Serbinë

në rrugën e saj drejt BE-së. Humbësit më të mëdhenj do të jemi ne dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të ketë një pozicionim të qartë të subjekteve politike në mënyrë që kur të arrihet marrëveshja, t'i përmbajë të gjitha elementet e kërkuara prej shumicës politike dhe të garantohet ratifikimi i saj.



Pjesëtarët e FSK-së marshojnë në kujtim të rrugës së betejave të Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

DRENAS, 1 NËNTOR (ER) - Kompania e Task Forcës për Kërkim dhe Shpëtim, Regjimenti i Mbrojtjes Civile të FSK-së, në Pomozotin, e udhëhequr nga komandanti Eset Loku, ka marshuar të enjten në kujtim të rrugës së betejave të Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, nga Pomozotini në Gllanassellë, te vendi i rënies

së tyre, e deri në Sheshin e Drenasit ku janë përjetësuar në bronz heroit dhe heroina. "I falënderova sinqerisht të gjithë pjesëmarrësit e këtij marshimi dhe urova që sa më shpejt FSK-ja edhe praktikisht të bëhet ushtri, në shërbim të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, duke përcjell amanetin e dëshmorëve

tanë, për shtet, sovranitet dhe integritet të vendit", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Gjatë qëndrimit në Sheshin "Fehmi Lladrovci" u zhvillua një mikpritje e jashtëzakonshme nga nxënësit dhe arsimtarët e shkollës "Rasim Kiçina".

rezolutë të përbashkët për çështje për të cilat pajtohen, duke u hapur mundësi negociatave të mëtutjeshme për t'u pajtuar për çështjet që kanë dallime. Përderisa ka pozicione rigjide për të gjitha subjektet politike do të jetë e vështirë arritja e konsensusit, sepse pikërisht me konsensus të gjitha palët duhet të lëshojnë pe nga pak, në mënyrë që të gjendet një e përbashkët e cila mund ta çojë vendin përpara dhe ta tejkalojë këtë krizë politike.

"Epoka e re": Ju si monitorues të punës së Kuvendit, shihni shkëndija për arritjen e këtij konsensusi?

Murati: Aktualisht do të jetë problem arritja e konsensusit, sidomos pas ngjarjeve që kanë ndodhur në seancën e së

QKUK-ja bëhet me 300 shtretër të rinj

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) të enjten i janë dorëzuar 300 shtretërit e parë nga kontingjenti prej 750 sish, të cilët janë blerë për klinikat e saj. Në dorëzimin e këtij kontingjenti, ministri

i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se ka qenë nevojë e kamotshme blerja e shtretërve të rinj, pasi disa prej shtretërve në QKUK nuk janë ndërruar me dekada të tëra. "750 shtretër modernë të pajisur me dyshekë për klinikat e QKUK-së. Kohës kur qytetarët tanë janë shtrirë në shtretër të vitit 1980 e të mbajtur nga bllo-

qet, dërrasat dhe dyshekët e stërvjetëruar, i erdhi fundi. Sot dorëzuar vetëm kontingjentin e parë prej 300 shtretërve për t'u siguruar qëndrim të dinjitetshëm qytetarëve tanë nëpër klinikat e QKUK-së", ka thënë ministri Ismaili.

Më tej, ai shtoi se ky është vetëm kontingjenti i parë dhe se në vitin

2019 do të blihen edhe shtretër të tjerë edhe për spitalet e përgjithshme. Kurse drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se me ardhjen e këtyre shtretërve do të përmirësohet qëndrimi i qytetarëve tanë nëpër klinikat e QKUK-së. "Blerja e shtretërve të rinj do ta përmirësojë hospitalizimin e qytetarëve

tanë, i cili deri më sot nuk ka qenë në nivelin më të mirë", ka thënë ai.

Prej 750 shtretërve të cilët kanë vlerën prej 1.3 milion eurosh, 300 prej tyre janë me tri thyerje, 100 me katër thyerje, 15 shtretër janë me katër thyerje për Ortopedi, 20 shtretër janë transportues dhe 300 të tjerë mekanikë.



Kryeprokurori Lumezi, pjesëmarrës në Ditën e Prokurorëve të Malit të Zi

BUDVË, 1 NËNTOR (ER) - Me ftesë të kryeprokurorit suprem të Malit të Zi, Ivica Stanković, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, po merr pjesë në konferencën dyditore të prokurorëve, e cila po mbahet në Budva të Malit të Zi. Kryeprokurori Lumezi para të pranishmëve ka mbajtur një fjalë rasti, duke shprehur falënderimin për ftesën dhe mundësinë për të qenë bashkë me homologët nga rajoni. "Është kënaqësi e veçantë që jemi pjesë e kësaj ngjarje dhe që na është dhënë mundësia për t'u takuar

me homologët e shteteve të rajonit", ka thënë Lumezi, duke shtuar se rreziqet bashkëkohore të sigurisë dhe drejtësisë nuk mund të zgjidhen nga një shtet i vetëm. "Për të arritur rezultate na duhet të forcojmë bashkëpunimin rajonal, sepse krimet me të cilat po ballafaqohemi i tejkalojnë kufijtë kombëtarë dhe paraqesin rrezik serioz për shtetet tona", u shpreh kryeprokurori Lumezi, duke shtuar se kjo jo vetëm që është sfidë, por është edhe detyrim. "Ne sot jemi vende që pretendojmë të integrohemi në BE dhe patjetër



jemi të detyruar në kuptim të plotë të fjalës, t'i aplikojmë standardet më të larta evropiane, me qëllim të ruajtjes së vlerave

demokratike dhe sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave të njeriut", ka theksuar ai. Po ashtu, kryeprokurori Lumezi ka

theksuar se Kosova është e vendosur të kontribuojë në thellimin e bashkëpunimit për të luftuar kundër krimit të organizuar, terrorizmit, pastrimit të parave dhe krimeve transnacionale dhe është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha shtetet e rajonit, por edhe me organizatat ndërkombëtare si Interpoli, Europol dhe Eurogjasti. "Me pranimin e Kosovës në këto organizata do të jetë më efikase lufta kundër krimit transnacional brenda rajonit", ka pohuar kreu i Prokurorisë së Shtetit të Kosovës.

LDK-ja emëron Besian Mustafën zëdhënës të partisë

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në mbledhjen e fundit të kryesisë ka caktuar Besian Mustafën zëdhënës të kësaj partie.

Besian Mustafa ishte kryeshf i Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve KIESA, punoi si udhëheqës në menaxhimin e investimeve dhe riskut në bankat komer-

ciale të Kosovës dhe kontriboi në themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Është i shkolluar në ShBA. Ka marrë diplomë të shkollës së

mesme në Ilionis të ShBA-së, bachelor të shkencave në drejtimit financa dhe kontabilitet në Pensilvani dhe master në administrim të biznesit në Nju Jork.



Mbahet konferenca e nëntë "FSK-ja dhe partnerët"

Tranzicioni i FSK-së, proces i pandalshëm



Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë me dije se tranzicioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri është proces i pandalshëm, i domosdoshëm dhe në interes të të gjithëve në Kosovë dhe në rajon. Në konferencën "FSK-ja dhe partnerët", Veseli e Haradinaj kanë thënë të premtën se ky tranzicion do ta ruajë edhe karakterin shumetnik të FSK-së pasi, sipas tyre, kjo forcë ka përmbushur të gjitha standardet e nevojshme për të kaluar në hapin tjetër të saj: formalizimin në ushtri të Kosovës

para së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë", është shprehur Veseli.

Kreu i Kuvendit ka shtuar se Kosova do ta ketë një ushtri dinjitoze, në shërbim të sigurisë nacionale, paqes dhe stabilitetit të rajonit dhe më gjerë, e cila do t'i bëjë krenarë të gjithë qytetarët e Kosovës, të të gjitha komuniteteve të saj. Ai ka theksuar se transformimi i FSK-së në ushtri është proces i pandalshëm, i domosdoshëm dhe në interes të të gjithëve në Kosovë dhe në rajon. "Transformimi i FSK-së në Ushtri e përmbyll ndërtimin e arkitekturës rajonale të sigurisë. E bën rajonin më stabil dhe më të gatshëm për integrimet euroatlantike dhe ndihmues në sfidat globale të sigurisë", ka deklaruar Veseli.

Duke komentuar zërat e fundit mbi, kinse, rrezikun e një destabilizimi të ri në Ballkan, Veseli ka thënë se këto ide janë reminishenca të së kaluarës, e cila është mbyllur njëherë e përgjithmonë. "E ardhmja e Ballkanit në BE nuk do të mund të shmanget nga askush. Është interesi dhe dëshira më e madhe e popujve dhe qytetarëve tanë. Është vizioni i forcave demokratike që nuk do të lejojnë të ndryshohet kursi properëndimor i rajonit tonë. Prandaj e them me bindje të plotë se paqja demokratike në rajonin tonë nuk ka alternativë. Pikërisht ky koncept i paqes demokratike qëndron në themel të FSK-së dhe në themel të partneritetit të saj me ndërkombëtarët", ka thënë Veseli.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se tranzi-

cioni i FSK-së është legjitim, është demokratik dhe është një proces gradual dhe synon të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe globale. Haradinaj ka pohuar se për të është nder që po merr pjesë në këtë konferencë dhe që është dëshmitar i rritjes së FSK-së dhe të një bashkëpunimi të jashtëzakonshëm me partnerët. Duke falënderuar të gjithë të pranishmit, gjeneralë, atashe ushtarakë, ambasadorë të akredituar në Kosovë, në veçanti gjeneralin Orr nga shteti i Iowas, kryeministri Haradinaj ka theksuar se tranzicioni i FSK-së është një kapitull i ri, por që do ta thellojë partneritetin edhe më tutje. "Tranzicioni i FSK-së është legjitim, është demokratik dhe një proces gradual dhe synon që të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe globale", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se ky tranzicion dëshmon pjekurinë dhe gatishmërinë për të marrë përgjegjësi më shumë së bashku.

Duke thënë se FSK-ja është forcë shumetnike, kryeministri Haradinaj ka potencuar se në asnjë mënyrë nuk do të tolerohet që të ketë dhunë apo kërcënime për pjesëtarët e saj dhe ka shtuar se edhe serbët e kanë rolin e tyre në Forcë, sepse edhe janë pjesë e saj. "FSK-ja nuk do ta zëvendësojë KFOR-in. KFOR-i është i mirëseardhur në shtetin tonë. FSK-ja nuk do ta zëvendësojë NATO-n. Prania e NATO-s në shtetin tonë është e mirëseardhur përgjithmonë dhe ne dëshirojmë t'i bashkohemi NATO-s, dëshirojmë të shërbejmë me ju dhe, FSK-ja, gjithashtu me tranzicion, është e gatshme të

shërbejë me ju kudo në botë", ka deklaruar Haradinaj.

Gatishmëria e Kosovës për t'iu bashkangjitur NATO-s, sipas kryeministrit Haradinaj, konfirmon edhe gjithë atë që ka bërë NATO-ja në mbështetjen, trajnimet dhe profesionalizimin e FSK-së dhe praktikave e mira të saj, si dhe është një investim i vlefshëm që kanë bërë për Kosovën. "FSK-ja është anëtare e koalicionit kundër terrorizmit, por ne jemi të gatshëm që të bëhemi anëtarë edhe të Interpolit, por që gjithashtu dëshirojmë të jemi anëtarë edhe të NATO-s", ka thënë ai.

Kryeministri përmes kësaj konference u ka bërë thirrje shteteve të NATO-s që ta ftojnë Kosovën dhe forcën e saj në ekipet e tyre. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka theksuar se prania e partnerëve tanë në këtë konferencë e bën FSK-në të krenohet me punën e përbashkët për paqe dhe siguri në vend dhe më gjerë. "Jemi zotuar të bëhemi ofrues rajonal i sigurisë dhe jo vetëm konsumues i saj", ka thënë ministri Berisha, duke shtuar se kjo nënkupton anëtarësimin përfundimtar në NATO. Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, ka deklaruar se tranzicioni i FSK-së është një proces i koordinuar me të gjithë dhe në harmoni me Kushtetutën tonë. "Ne do të jemi storie suksesi për Kosovën dhe do ta vazhdojmë së bashku partneritetin, raportet miqësore dhe ne do ta udhëheqim forcën tonë të ardhshme", ka thënë Rama. Ndërkaq gjenerali Tomothy Orr ka pohuar se e ardhmja e FSK-së është shumë e ndritur dhe se do të vazhdohet me mbështetjen edhe më tutje.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINE, 1 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të enjten në konferencën "FSK-ja dhe partnerët". Në këtë konferencë ishin të pranishëm edhe ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, përfaqësues të vendeve partnere, nga Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, KFOR-i, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave si dhe ambasadorët e akredituar në vendin tonë nga shtete të ndryshme.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës është formacioni më modern ushtarak në rajon falë partneritetit të gjithanshëm me NATO-n, Aleancën më të fuqishme dhe më demokratike të sigurisë në botë. Ai ka thënë se në themel të lirisë, të pavarë-

sisë dhe të shtetformimit të Kosovës qëndron një vlerë e madhe, partneriteti me botën perëndimore.

Kreu i Kuvendit ka pohuar se FSK-ja është shembulli më i mirë i funksionimit të këtij partneriteti. Duke përgëzuar ushtarët e FSK-së dhe eprorët e saj për punën e madhe dhe shumë profesionale që janë duke bërë, Veseli i cilësoi ata nderi bashkëkohor i Kosovës. Ai tha se të rralla janë rastet që një ushtri në formim e sipër të prezantohet kaq dinjitetshëm në botë sikurse është FSK-ja, kuadrot e së cilës kanë shkëlqyer duke marrë medalje në garat ndërkombëtare më prestigjioze. "Kjo flet për nivelin e lartë të përgatitjes profesionale dhe përvetësimit të standardeve më bashkëkohore të ushtrive më moderne të kohës sonë. Kjo flet se FSK-ja ka përmbushur të gjitha standardet e nevojshme për të kaluar në hapin tjetër të saj: formalizimin në ushtri të Kosovës. Ne para pak ditësh në Kuvendin e Kosovës miratuar tri ligjet e nevojshme për avancimin e këtij procesi dhe jemi të vendosur që të ecim për-

AKP-ja miraton 20-përqindëshin për punëtorët e tri ndërmarrjeve

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar transaksionet e shitjes së asetëve përmes likuidimit 41, si dhe ka miratuar listën e asetëve të luajtshme të ndërmarrjes shoqërore "Rilindja" për shitje si

pjesë e listës së Shitjes së Asetëve nr. 43 (SHAL 43). Veç kësaj, Bordi ka miratuar propozimin për qiradhënie të asetit të ndërmarrjes shoqërore (NSH) "Metaliku", depo e prodhimeve të gatshme nën administrim direkt, si dhe disa qiradhënie të tjera. "Bordi diskutoi dhe miratoi raportet rekomanduese për

transformimin e pronës shoqërore përmes procedurës së negociimit të drejtpërdrejtë të komisionit për asete specifike për rajonin e Prishtinës. Për më tepër në këtë takim Bordi shqyrtoi dhe miratoi edhe raportet e komisionit për shqyrtimin e ankesave të listave për 20 përqind të punëtorëve për tri NSH:

NSH 'Fabrika e Amortizatorëve' në Prishtinë; NSH 'Mlladost' në Shtërpcë dhe NSH 'Pertrans' në Pejë, si dhe raportet e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përcaktim të statusit të ndërmarrjeve për: i) Asetet në Kosovë të ndërmarrjes 'Solid' Soboticë, ZR Prishtinë, ii) Ndërmarrja Qendra e

Rekreationit për Fëmijë dhe të Rinj-Pishat e Deçanit, ZR Pejë; dhe iii) Ndërmarrja Bashkësia e Sigurimit të Pasurisë dhe Personave 'Kosova' ZR Prishtinë. Bordi, po ashtu, miratoi raportin e radhës të Komisionit për Banesat e NSH-ve", është thënë në njoftimin për media të AKP-së.



Bizneset turke të interesuara për investime në Kosovë



PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Zëvendësministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, Rejhan Vuniqi, në shoqërim edhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, kanë pritur të enjten në një takim të përbashkët, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, përfaqësuesit e 12 bizneseve turke nga Shoqata "Rumelisiad". Me këtë rast, zëvendësministria Vuniqi dhe ministri Lluka i kanë njoftuar mysafirët për mundësitë e mëdha që ekzistojnë për investime në vendin tonë, në veçanti për sektorët që ofron

mbështetje Ligji për Investime Strategjike, duke i ftuar ata të investojnë në Kosovë.

Ndërsa kryetari i kësaj shoqate, Omer Kumova, i ka falënderuar përfaqësuesit e institucioneve të vendit për mikpritjen, duke theksuar se për dallim prej herëve të tjera, janë kthyer me një optimizëm të madh. "Jemi të inkurajuar nga klima që është krijuar nga ana e Qeverisë së Kosovës, me reformat e saj ligjore, si dhe nga niveli i rritur i cilësisë së bizneseve në Kosovë për të bashkëpunuar me to", është shprehur Kumova.

Ministria e Infrastrukturës ua hap dyert studentëve për punë praktike

Prishtinë, 1 nëntor (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, është takuar të enjten me rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan

Prishtina", Marjan Dema, me të cilin ka biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Universitetit të Prishtinës.

"Rektorit Dema i premtova për hapje të dyerve të MI-së për praktikë të studentëve të UP-së në departamentet përkatëse dhe mundësi trajnimi për ta. Nga ai

kërkova të mos hezitojë dhe të paraqesë ndonjë nevojë infrastrukurore për kompleksin universitar", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".





Kosova ka potenciale të mëdha të energjisë solare dhe asaj të erës

Drejtori ekzekutiv i "Balkan Green Foundation", Visar Azemi, ka thënë se tranzicioni i energjisë është një fenomen global ndaj të cilit Kosova nuk është e veçuar. Sipas tij, Kosova ka potenciale të mëdha të energjisë solare dhe asaj të erës dhe, në këtë drejtim, ka theksuar se investimet në burimet e ripërtëritshme duhen shtuar

EPOKA E RE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - "Balkan Green Foundation" dhe "Germanwatch" organizuan konferencën për tranzicionin e energjisë "Sfidat dhe mundësitë në Kosovë dhe rajon", ku u shpjeguan sfidat, strategjitë e politikave si dhe rruga drejt një tranzicioni të energjisë në Kosovë dhe në rajon. Drejtori ekzekutiv i "Balkan Green Foundation", Visar Azemi, ka thënë se tranzicioni i energjisë është një fenomen global ndaj të cilit Kosova nuk është e veçuar. "Tranzicionin e energjisë e kemi

mësuar nga miqtë tanë gjermanë, të cilët dëshmuar se tranzicioni i energjisë është i mundur dhe tani ne jemi duke punuar së bashku për t'i eksploruar mundësitë që Kosova ka në këtë fushë. Kosova ka potenciale të mëdha të energjisë solare dhe asaj të erës, andaj investimet në burimet e ripërtëritshme duhen përshejtuar", ka deklaruar Azemi. Pjesë e konferencës ishin edhe Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Christian Heldt, ambasadori gjerman në Kosovë dhe Riccardo Serri, shefi i sektorit për Politikë, Ekonomi dhe Integrim Evropian në Zyrën

e BE-së në Kosovë, të cilët morën fjalën për të diskutuar mbi rrugën drejt një të ardhmeje të begatë dhe të qëndrueshme të sistemit energjetik në Kosovë e rajon.

Përgjatë fjalimeve të tyre u cek se është e rëndësishme siguria e furnizimit me energji, përballeshmëria e çmimeve nga qytetarët, mbrojtja e ambientit dhe integrimi i burimeve të ripërtëritshme në sistemin energjetik, duke punuar kështu në arritjen e një tranzicioni energjetik në Kosovë dhe rajon. Konferenca u nda në dy panele diskutuese.

Paneli i parë ka diskutuar mbi rëndësinë e integritimit të burimeve të ripërtëritshme në sistemin energjetik, duke shqyrtuar politikën që nxisin efikasitetin e energjisë dhe kalimin nga qymyri në burimet e ripërtëritshme, të cilat janë thelbësore për arritjen e një tranzicioni energjetik në Kosovë dhe rajon.

Gjatë diskutimit u tha se tranzicioni në energji nuk nënkuptohet vetëm në ndryshimin e burimeve të energjisë, por edhe në përfshirjen e tranzicionit social, duke zhvendosur një sistem të centralizuar të energjisë në atë ku qytetari dhe konsumatori janë në qendër të zhvillimit të energjisë. Ky panel u përbë nga zyrtarë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, DG ENER, Balkan Green Foundation, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe GIZ.

Ndërsa paneli i radhës ka shqyrtuar sfidat dhe mundësitë e investimeve në sektorin e energjisë nga perspektiva e ekonomisë, ligjit, teknologjisë në dispozicion dhe investitorëve potencialë. Përveç kësaj, panelistët debatuan mbi prioritetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë zbatimin e pakos së tretë të energjisë dhe integrimin në treg në nivel rajonal si dhe në tregjet evropiane.

Pjesë e këtij paneli ishin përfaqë-

sues nga KOSTI, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Germanwatch, Agora Energiewende, Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe nga SOWI Kosovo. Të pranishëm në konferencë ishin përfaqësues të institucioneve vendore dhe të huaja, të shoqërisë civile, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, profesorë dhe studentë të cilët kontribuan me diskutime konkrete për adresimin e çështjeve me interes të përbashkët në rrugën e Kosovës për zhvillimin dhe tranzicionin e energjisë.

Gjatë diskutimeve me pjesëmarrësit u theksua se duke marrë parasysh se rajoni është shumë i varur nga lëndët djegëse fosile, është e domosdoshme që agjendat e zhvillimit të energjisë ta prioritojnë diversifikimin e burimeve të energjisë, duke pasur qëndrueshmërinë, besueshmërinë dhe përballeshmërinë si gur themelet e politikave të tyre të energjisë.

Hamza njofton delegacionin e bizneseve gjermane për të bërit biznes në Kosovë

EPOKA E RE
A. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka prituri të enjten në takim një delegacion të përfaqësuesve të Shoqatës së Bizneseve të Gjermanisë Lindore, të kryesuar nga drejtore-sha rajonale e Evropës Juglindore, Anja Quiring, si dhe të shoqëruar edhe nga zëvendësambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë Jan Axel Voss.

Ministri Hamza dhe delegacioni i përfaqësuesve të Shoqatës së Bizneseve të Gjermanisë Lindore diskutuan në lidhje me bashkëpunimin ekonomik mes të dyja vendeve si dhe për mundësitë e rritjes së investimeve

të bizneseve gjermane në Kosovë dhe anasjelltas. Hamza ka falënderuar shtetin dhe taksapaguesit gjermanë për kontributin që kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin për Kosovën ku, sipas tij, falë këtij kontributi janë realizuar reforma dhe projekte tejet të rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Gjatë takimit ministri Hamza i informoi përfaqësuesit e bizneseve gjermane për situatën ekonomike në vend, me theks të veçantë për ambientin e të bërit biznes në Kosovë dhe për reformat e ndërmarrja nga Ministria e Financave për krijimin e kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat si bartës kryesor i zhvillimit ekonomik. Në këtë takim u diskutua edhe për projektin e



përbashkët të Parkut të Inovacionit në Prizren, ku Qeveria e Kosovës përmes ministrit të linjës ka një rol aktiv drejt funksionalizimit të tij. Ndërsa përfaqësuesit e Shoqatës së Bizneseve

Gjermane vlerësuan lart angazhimin e ministrit Bedri Hamza dhe të Ministrisë së Financave për realizimin e projektit të Parkut të Inovacionit në Prizren. Ata shprehën interesimin e tyre për mundësinë e

investimeve në Kosovë, ku me këtë rast vlerësuan angazhimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Financave për krijimin e një klime sa më të mirë të të bërit biznes, sidomos përmes reformave të politikave fiskale.

Jashari fton qytetarët për pastrimin e Skenderajt

Skenderaj, 1 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka ftuar qytetarët e kësaj komune t'i bashkohen aksionit për pastrimin e Skenderajt. "Të dashur qytetarë të Skenderajt, në vazhden e aktiviteteve tona për ta mbajtur sa më pastër ambientin në të cilin frymojmë e jetojmë, për të hequr mbeturina sa më shumë që mundemi dhe për ta kthyer komunën tonë në një gjendje pa bërrlok, ju ftojme që të premtën nga ora 10:30 t'i bashkoheni aksionit të pastrimit. Ta fuqizojmë sa më shumë aksionin e pastrimit për të mirën e fëmijëve, për jetët tona. Për Skenderajn pa mbeturina!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

na sa më shumë që mundemi dhe për ta kthyer komunën tonë në një gjendje pa bërrlok, ju ftojme që të premtën nga ora 10:30 t'i bashkoheni aksionit të pastrimit. Ta fuqizojmë sa më shumë aksionin e pastrimit për të mirën e fëmijëve, për jetët tona. Për Skenderajn pa mbeturina!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".



Në Junik mbahet manifestimi 'Dita e gështenjës'

JUNIK, 1 NËNTOR - Sot (e premte) në orën 11:00 në Qendrën Rajonale të Turizmit n'Dukagjin (QRT- Kulla e Isufaj)

në Junik mbahet manifestimi "Dita e gështenjës". Ky manifestim është organizuar nga Komuna e Junikut në

bashkëpunim me Organizatën Holandeze për Zhvillim në Kosovë CNVP (Bashkojmë Vlerat e Natyrës me Njerëzit).



Lladrovci nënshkruan marrëveshje për financimin e 20 bursave për studentë

DRENAS, 1 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë "Altrade Holding" dhe "Altrade Center" me të cilët ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit për financimin e 20 bursave për studentët e kësaj komune. Në kuadër të marrëveshjeve, kompania "Altrade Holding" financon dhjetë bursa dhe "Altrade Center" dhjetë të tjera për vitin akademik 2018/2019.

Vlera e një burse për gjithë vitin akademik është 500 euro, 50 euro për muaj. Lladrovci ka falënderuar përfaqësuesit e kompanisë për këtë ndihmë dhe ka vlerësuar se ky investim në studentët e dalluar do të jetë për të mirën e vendit, sepse të njëjtit do ta shfrytëzojnë profesionalizmin në Drenas dhe Kosovë.

Komuna e Drenasit nga buxheti komunal këtë vit ka ndarë 160 bursa, 140 prej tyre për nivelin bachelor dhe 20 për master.

Ndërsa 20 bursat nga të dy kompanitë që kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, studentët përfitues do të jenë të nivelit bachelor dhe sipas ranglistës pritëse, nga numri 141 deri në numrin 160. Kryetari Lladrovci ka thënë se përfitues të bursës për studentët e nivelit bachelor dhe master përmes donatorëve do të jenë të gjithë ata që i kanë plotësuar kriteret e konkursit, që janë në listën pritëse, pra gjithsejtë 227 studentë.

Prokuroria e Prizreni ngre aktakuzë ndaj një ish-drejtorit komunal

PRIZREN, 1 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, konkretisht Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B. N., ish-drejtor i Drejtorisë Komunale të Inspektorateve në Prizren, për shkak se dyshohet se ka kryer veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Sipas aktakuzës, i pandehuri B. N., si person zyrtar, me mosveprim, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk e ka përmbushur detyrën zyrtare, me qëllim të përfitimit të dobisë për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, në atë mënyrë që në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë Komunale të Inspektorateve në Prizren nuk i ka siguruar kushtet për t'i

ekzekutuar konkluzionet e lëshuara nga inspektorët e ndërtimtarisë për rrënimin e detyrueshëm të mbindërtimeve dhe ndërtimeve të katër objekteve hoteliere në afërsi të Sheshit "Shatërvan" në Prizren, të ndërtuar pa leje apo në kundërshtim me lejet e dhëna, të gjitha këto të ndërtuara në Zonën e Parë të Qendrës Historike në Prizren, me ç'rast është dëmtuar trashëgimia kulturore e arkitektonike e Qendrës Historike të Prizrenit si dhe për shkak të mospagesës së detyrimeve është dëmtuar buxheti i Komunës së Prizrenit për 36 143 euro. I pandehuri ka kryer veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Nisin punimet në rrugët 'Shaqir Igrishta' dhe 'Ndue Përllëshi' të kryeqytetit

PRISHTINË, 1 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për shtrimin e kubëzave të reja në rrugët

'Shaqir Igrishta' dhe 'Ndue Përllëshi'. Po ashtu, ai ka thënë se me këtë rast do të vendoset edhe gypi i kanalizimit i cili do të mundësojë që ndërtesat përgjatë rrugës të kyçen në mënyrë të

rregullt në rrjetin e ujërave të zeza. "Sot filluan punimet në shtrimin e kubëzave të reja në rrugët 'Shaqir Igrishta' dhe 'Ndue Përllëshi'. Po e shfrytëzojmë rastin për ta vendosur edhe

gypin e kanalizimit. Ky gyp do t'u jap mundësi ndërtesave përgjatë rrugës të kyçen në mënyrë të rregullt në rrjetin e ujërave të zeza", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Agjencia britanike për Krime po heton fushatën për Brexit

LONDËR, 1 NËNTOR - Agjencia Kombëtare për Krime në Britani është duke hetuar biznesmenin Arron Banks dhe fushatën e tij LeaveEU për shkelje që mund të jenë kryer gjatë fushatës së vitit 2016 në referendumin për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian. Banks dhe një tjetër figurë e rëndësishme e fushatës, Liz Gilney, janë dërguar në këtë agjenci nga Komisioni Zgjedhor.

Ky vëzhgues ka thënë se dyshon se fushata është financuar me para që kanë ardhur nga "burime të palejueshme".

Banks ka dënuar çdo keqbërje dhe ka thënë se ka mirëpritur hetimin e Agjencisë Kombëtare për Krime. Ai ka thënë se "një hetim bindës dhe i sinqertë do t'u japë fund supozimeve qesharake kundër meje dhe kolegëve të mi". "Nuk ka të dhëna për ndonjë keqbërje nga kompanitë që zotëroj unë. Unë jam taksapagues britanik dhe nuk kam pranuar kurrë donacione të huaja. Komisioni Zgjedhor nuk ka ofruar të dhëna kundërthënëse", ka thënë ai në një deklaratë. Ai ka pretenduar se Komisioni Zgjedhor ka

vepruar "nën presion të madh politik nga mbështetësit kundër Brexitit".

Hetimet e Komisionit Zgjedhor janë fokusuar në dy milionë funte që është raportuar t'i jenë huazuar kompanisë që ka drejtuar fushatën kryesore për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian. Referendumi i mbajtur në qershor të vitit 2016 në Britani ka kërkuar nga qytetarët ta tregojnë mendimin e tyre nëse Mbretëria e Bashkuar duhet të largohet nga Bashkimi Evropian. Në bazë të rezultat-



eve, 51,9 për qind kanë votuar në të mirë të largimit dhe 48.1 për qind kundër. Pas këtij rezul-

tati, Britania pritet të largohet nga BE-ja më 29 mars të vitit 2019.

Trumpi, fushatë për kandidatët republikanë

Ndërsa kanë mbetur vetëm pak ditë deri në zgjedhjet për Kongresin, republikanët po marrin një shtysë të fortë nga Shtëpia e Bardhë, pasi që presidenti Donald Trump po bën fushatë në mbështetje të kandidatëve republikanë në garat kyçe për Senatin

WASHINGTON, 1 NËNTOR - Zgjedhjet e Kongresit më 6 nëntor mund ta zhvendosin balancën e pushtetit në Uashington dhe presidenti Donald Trump po bën fushatë për kandidatët e partisë së vet. Ndërsa kanë mbetur vetëm pak ditë deri në zgjedhjet për Kongresin, republikanët po marrin një shtysë të fortë nga Shtëpia e Bardhë. Presidenti Donald Trump po bën fushatë në mbështetje të kandidatëve republikanë në garat kyçe për Senatin.

Megjithëse këto votime nuk janë për presidentin, kryetari i Bashkimit Konservator Amerikan, Matt Schlapp, thotë se presidenti Trump është një shtysë e madhe për disa nga votuesit në këto zgjedhje. "Është e pashmangshme që të shihet si referendum për presidentin, sepse ai dominon në politikë. Ai

është në qendër të çdo cikli mediatic, kështu që megjithëse mund të mos jetë faktori kryesor për çdo garë, në ditën e zgjedhjeve nuk ka diskutim që disa vota do të përcaktohen nga ajo që mendojnë votuesit për Donald Trumpin", tha Schlapp. Disa kritikë të presidentit kanë fajësuar retorikën e tij të nxehtë si nxitëse të armiqësisë dhe zemërimit në disa drejtime. Kjo vjen pas një jave të dhunshme ku 11 besimtarë u vranë në një sinagogë në Pitsburg dhe një person nga Florida u arrestua për dërgimin e pakove-bombë 13 demokratëve me peshë dhe televizionit CNN. "Ajo që nuk dimë është se sa do të ndikojë te zgjedhjet kjo atmosferë në vend, por ajo që dihet është se e ka larguar vëmendjen nga çështjet e rëndësishme për presidentin, si imigracioni apo karvani. Ai do të përipiqet ta rikthejë me



shpejtësi vëmendjen tek ato", thotë Jim Malone, korrespondenti kryesor për politikën në "Zërin e Amerikës".

Edhe demokratët po përipiqen ta zhvendosin vëmendjen, duke e vënë më shumë theksin te çështja e kujdesit shëndetësor. "Presidenti po përipiqet të bëjë shumë zhurmë. Mendoj se publiku është i interesuar për çësht-

jet kryesore dhe në këtë moment mendoj se çështja e kujdesit shëndetësor është shumë e rëndësishme për demokratët sepse republikanët janë përpjekur ta shfuqizojnë programin e ish-presidentit Obama, përfshirë mbulimin me sigurime për ata që kanë sëmundje ekzistuese", thotë Martin Frost, ish-anëtar

demokrat i Kongresit dhe autor i librit "Ndasi të politike". Analistët politikë thonë se ruajtja e shumicës republikane në Senat është shpresa më e madhe për Donald Trumpin. Në bazë të sondazheve, demokratët duket se kanë gjasa të fitojnë në Dhomën e Përfaqësuesve kur amerikanët të shkojnë në kutitë e votimit të martën.



Nisin patrullimet e përbashkëta turko-amerikane në Minbej

Ankara, 1 nëntor - Agjencia shtetërore turke e lajmeve "Anadolu" ka njoftuar se forcat e armatosura turke dhe amerikane nisën të enjten patrullimet e përbashkëta në Minbej, një qytet në veri të Sirisë, i dominuar nga një mili-

ci kurde, e konsideruar "terroriste" nga ana e Turqisë, por aleate e ShBA-së. "Patrullimi i përbashkët midis forcave të armatosura turke dhe amerikane në Minbej nisi sot rreth orës 15:53 (12H53 GMT)", deklaroi ministri turk i

Mbrojtjes, Hulusi Akar, cituar nga agjencia "Anadolu". Patrullimi vijon deri në afërsi të lumit Sajur, një zonë që shtrihet midis Minbej dhe Jarablous, një qytet i kontrolluar nga rebelët e mbështetur nga Ankaraja.

Gjendet kutia e zezë e avionit që u rrëzua në Indonezi

XHAKARTË, 1 NËNTOR - Autoritetet në Indonezi gjetën "kutinë e zezë" të një aeroplani që u rrëzua të hënën në Detin Java. Kutia përmban të dhënat e flu-

turimit JT 610, që i përkiste kompanisë Lion Air. Aeroplani, me 189 njerëz në bord, u rrëzua shumë shpejt pasi u nis nga Xhakarta - kryeqyteti i

Indonezisë. Asnjë i mbijetuar nuk është gjetur. Po ashtu, nuk dihet se çfarë e ka shkaktuar incidentin, por kutia e zezë tani pritet t'i ndihmojë ekspertët e

sigurisë së aviacionit për ta përcaktuar shkakun. Ishte raportuar se avioni ka pasur probleme teknike gjatë disa fluturimeve të mëhershme.




Bardhyl Mahmuti e fton Dick Martyn në ballafaqim publik

LOZANË, 1 NËNTOR (ER) - Ish-përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Bardhyl Mahmuti, e ka takuar të mërkurën Dick Martyn në Lozanë të Zvicrës, ku ky i fundit ka promovuar librin e tij "Une certaine idée de la justice - Tchétchénie, CIA-Kosovo-droga" (Njëfarë ideje për drejtësinë - Çeçenia, CIA-Kosova-droga). Me këtë rast, Mahmuti i ka dhuruar Martyt

librin e tij "Mashtrimi i madh", duke e ftuar për ballafaqim publik rreth pikëpamjeve denigruese dhe akuzave monstruoze që Marty i bën në adresë të UÇK-së. "Mbrëmë, më 31 tetor 2018, në librarinë prestigjioze 'Payot' në Lozanë të Zvicrës, u bë promovimi i librit të Dick Martyt, i titulluar 'Une certaine idée de la justice - Tchétchénie, CIA-Kosovo-droga' (Njëfarë ideje për

drejtësinë Çeçenia, CIA-Kosova-droga). Shkova dy orë më herët se ora e përcaktuar për fillimin e promovimit. E bleva librin në fjalë dhe e lexova kapitullin XIX, që i ishte kushtuar ekskluzivisht Kosovës. Para se të fillonte promovimi i librit, takova Dick Martyn. Pasi iu prezantova, e njoftova se jam autor i librit 'Mashtrimi i madh', të cilin paraprakisht i kam dërguar një kopje të librit me postë elektronike në adresën e tij, kur ishte profesor në Universitetin e Neuchâtelit. I tregova shkurtimisht se libri zhvesh mashtrimin e madh që është bërë lidhur me luftën e Kosovës dhe me UÇK-në dhe se ai ishte një nga protagonistët kryesorë të librit. E ftova që të ballafaqohemi publikisht në ndonjë universitet të Zvicrës, në prani të studentëve dhe profesorëve të interesuar për këtë debat dhe i propozova Universitetin e Gjenevës, ku mund të organizohej një ballafaqim i tillë. I propozova Universitetin e Gjenevës për shkak se, paraprakisht, kisha



biseduar me Albana Krasniqin Malajn, drejtoreshën e Universitetit Popullor Shqiptar në Gjenevë, e cila shprehu gatishmërinë ta siguronte mbajtjen e këtij debati", ka treguar përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Bardhyl Mahmuti. Dick Marty e ka pranuar librin e

Mahmutit, të cilit i ka thënë se pasi ta lexojë do të flasim edhe për debatin. "Librin tim e pranoi me gjithë qejf dhe më tha se, sapo ta përfundonte së lexuari, do të më kontaktonte që ta organizonim debatin", ka thënë autori i librit "Mashtrimi i madh", Bardhyl Mahmuti.



Punonjësit e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë marrin pagat me rritje 50 për qind

Nga dita e enjte edhe zyrtarisht krijuesit dhe performuesit e kulturës si dhe punonjësit profesionalë të trashëgimisë kulturore do të gradohen dhe do t'i marrin pagat e tyre me rritje, siç edhe pati premtuar javë më parë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Solemnisht, punonjësit të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kanë nënshkruar kontratat e reja në bazë të rregullores së re e cila parasheh rritjen e pagave për këto kategori.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se që nga marrja e mandatit ai është angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e politikave kulturore, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për kulturën dhe trashëgiminë kulturore. "Përpjekjet tona po materializohen sot me nënshkrimin e kontratave në mes të punonjësve dhe të MKRS-së. Urime për të gjithë krijuesit, performuesit dhe punonjësit e trashëgimisë kulturore për nënshkrimin e kontratave të reja. Sot kemi mbledhur këtu për të bashkëbiseduar lidhur me zba-

timin e rregullores për gradat dhe pagat e punëtorëve të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore dhe që solemnisht të marrim pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të kontratave të reja në bazë të rregullores së re me të cilën janë ngritur pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe të punëtorëve të trashëgimisë kulturore", ka thënë ministri Gashi. Ai ka vlerësuar se, përveç faktit të një trajtimi dinjitoz dhe merit të punonjësve të këtyre fushave, kontratat e reja janë në kuadër të mbështetjes dhe përforsimit të kapaciteteve njerëzore. "Me miratimin e Rregullores kemi dhënë përgjigjen e duhur dhe meritore për çështjet e sistematizimit të pagave, gradimit dhe kategorizimit të krijuesve, performuesve të kulturës dhe punonjësve të trashëgimisë kulturore. Kemi krijuar parakushtet për t'i arritur objektivat e përcaktuara në politikat programore për kulturë e



trashëgimi kulturore", ka sqaruar Gashi.

Ai ka theksuar se jeta e pasur kulturore dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore janë përcaktime jetike të MKRS-së. "Ne po punojmë vazhdimisht që me politikën në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore ta sigurojmë promovimin e kulturës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të vendit tonë, ta sigurojmë ruajtjen identitetin e shoqërisë sonë dhe një të ardhme të ndriçuar për kulturën dhe mbrojtjen

e trashëgimisë kulturore në vendin tonë", ka dhënë mesazhin e tij në fund ministri, duke i inkurajuar dhe porositur përfituesit nga rritja e pagave që të fokusohen në punë kreative e sa më profesionale në fushat e kulturës e trashëgimisë.

Ndërkaq në emër të përfaqësuesve të institucioneve vartëse të MKRS-së, Semira Latifi ka falënderuar ministrin Gashi për realizimin e premtimit të dhënë. "Kërkesa jonë e kamotshme u realizua, dhe për këtë, ndër me

meritorët është ministri z. Kujtim Gashi, për të cilin shprehim konsideratë dhe respekt të veçantë që e mbajti fjalën e dhënë. Ndoshta edhe mund të dukemi naivë, ndoshta për dikë edhe entuziastë, por ne duam që kjo ditë të shënohet si një shembull dhe shtytje edhe për zyrtarë të tjerë shtetërorë. Të kuptohet se sa e rëndësishme është realizimi i një premtimi publik dhe sa me shpresë bëhemi kur përgjegjësit tanë realizojnë atë që e thonë", ka thënë Latifi.

E rrallë

Kanada, deputetët festojnë "Halloween"-in në parlament

Deputetët kanadezë kanë festuar "Halloween"-in në një seancë parlamenti. Disa nga deputetët kanë vendosur të marrin pjesë me maska. Kryeministri Justin Trudeau ka shpërndarë në rrjetet sociale një fotografi ku thotë se disa nga deputetët nuk njiheshin jo



vetëm nga pamja e jashtme, por edhe nga pyetjet që bënin.

BARSOLETA E DITËS



Një turist pyet një djalë:
 - Sa shkoj ora?
 - Dymbëdhjetë e natës.
 - Mendova se mos kishte shkuar më tepër.
 - Në fshatin tonë nuk shkon më tepër, se fillon prapë nga njëshi.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
 Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
 Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
 Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
 Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
 Regjia: Ruben Fleischer
 Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një burrë tërheq një varkë në liqenin Victoria në plazhin e Kichinjio në Kisumu të Kenias perëndimore. /AFP/

E rrallë

Varrezat më të famshme në Paris

Në botën moderne është e vështirë që vdekja dhe e bukura të vendosen në të njëjtën fjalë, por arti i mendjes krijuese të njeriut e ka futur të bukurën edhe në stacionin e fundit të jetës. Varrezat Père Lachaise në Paris sot kanë me dhjetëra mijëra varre, edhe të disa personave të



famshëm të letërsisë. Pra, përveçse një vend varrimi, kthehen edhe pika historike, oaze në mjedisin urban.

 <p>DASHI Fillimi i nëntorit do të ketë ndryshime në gjendjen tuaj financiare, por kjo nuk do t'ju bëjë përshtypje sepse nuk jeni i dhënë pas parave.</p>	 <p>DEMI Kureshtarë të lindur sot do të kërkonin të dini edhe gjëra të cilat nuk ju takojnë. Do të merrni një këshillë të vyer që do ta zbatoni me përpikëri.</p>	 <p>BINJAKËT Dialogu që keni vendosur me një të lindur të shenjës së Peshores për ju është mjaft i rëndësishëm. Varen shumë projekte nga ky komunikim.</p>	 <p>GAFORRJA Për ata nga ju që kanë aktivitete personale ose që lidhen me turizmin, sot do të ketë ndryshime të mëdha. Përgjigjet që prisnit do t'i merrni sot.</p>	 <p>LUANI Ditë me mjaft zhvillime sa i përket anës suaj sentimentale. Për ju që prisni një lidhje diçka nuk do të shkojë mirë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Do të jetë mjaft e vështirë sot për t'ju bërë të buzëqeshni. Një situatë e ndërlikuar ka sjellë shumë tension te ju.</p>
 <p>PESHORJA Ky muaj do të jetë mjaft produktiv për ju. Kudo do të keni të reja dhe udhëtime të këndshme parashikohen në javët e para.</p>	 <p>AKREPI Nostalgjikë sot për këdo që ka qenë pjesë e jetës suaj në të shkuarën, kështu po ndiheni që në orët e para të mëngjesit. Ditë e qetë dhe pa luhatje.</p>	 <p>SHIGJETARI Më në fund do ta pranoni ftesën e dikujt që ka kohë që po flirton me ju. Ndiheni të ngacmuar nga e panjohura dhe po ju pëlqen kjo lojë.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni mjaft racionalë në përgjithësi dhe një rrëshqitje e vogël sot nga linja juaj do të bëjë shumë përshtypje te njerëzit që ju qëndrojnë pranë.</p>	 <p>UJORI Ambicia dhe krenaria sot nuk do të jenë në orbitën tuaj. Mjaft komunikues dhe të lirshëm po jetoni një periudhë të ngrorhtë dhe romantike.</p>	 <p>PESHQIT Problemet më të mëdha sot do t'i keni në punën tuaj dhe nuk do të dalin në pah që në fillim, por pasi të keni përfunduar çdo gjë.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AC AJACCIO - AJACCIO GFCO

1

TOP OSS - FC EINDHOVEN

1

MINSK - GORODEYA

1

Gjysma e ekipeve të Superligës ndërrojnë trajnerët

Gjashtë klube elitare kanë bërë ndryshime trajnerësh deri tash, kurse nuk përjashtohen edhe lëvizje të tjera në xhirot e mbetura të sezonit vjeshtor. I fundit që ka dhënë dorëheqje është trajneri nga Shqipëria, Gugash Magani. "Nuk jam më trajner i Trepçës '89, kam dhënë dorëheqje, sepse jemi larg objektivave që kemi pasur në fillim të kampionatit. Nuk dua të bëj analizë, por t'i falënderoj të gjithë futbollistët, stafin tim, presidentin në veçanti, tifozët e Mitrovicës që më kanë respektuar shumë", ka thënë Magani



onatit. "Nuk jam më trajner i Trepçës '89, kam dhënë dorëheqje, sepse jemi larg objektivave që kemi pasur në fillim të kampionatit. Nuk dua të bëj analizë, por t'i falënderoj të gjithë futbollistët, stafin tim, presidentin në veçanti, tifozët e Mitrovicës që më kanë respektuar shumë", ka thënë Magani.

Këtë të fundit deri në fund të sezonit vjeshtor do ta zëvendësojë ndihmëstrajneri Sabit Osmani, i cili edhe në të kaluarën ka zëvendësuar trajnerët e larguar nga "Riza Lushta". Largimin e Maganit e ka bërë publik edhe skuadra e Trepçës '89 nëpërmjet një njoftimi për medie. "Shkaku dhe arsyeja e largimit të profesorit Magani është mospërfillja dhe moszbatimi i detyrave nga vetë lojtarët për të cilat kanë pasur obligim t'i zbatojnë", thuhet në njoftimin e 89-shit. Deri në përfundim të sezonit vjeshtor numri i trajnerëve të dorëhequr apo të shkarkuar pritet të rritet, pasi kjo është një dukuri e njohur në futbollin e Kosovës.

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Kanë kaluar 13 xhiro në IPKO Superligën e Kosovës në futboll dhe deri tash gjysma e skuadrave të elitës kanë bërë ndryshime në krye të shtabeve teknike. Këtu bëjnë pjesë kryesisht skuadrat që kanë synim titullin e kampiones, por nuk mungon as KEK-u që ka fituar vetëm një pikë nga trembëdhjetë ndeshjet e luajtura. Skuadra nga Obiliqi ishte e para që filloi "lojën" me emërime dhe largime të trajnerëve, pasi gjatë verës e zyrtarizoi Musa Selimin shef të shtabit teknik, por "Profia"

nuk e udhëhoqi fare në Superligë. Enis Nasufi e drejtoi këtë klub për disa xhiro e më pas vendin e tij e zuri Mensur Siminica, i cili ishte ndihmëstrajner.

E dyta që bëri ndryshime në shtabin teknik ishte skuadra e Feronikelit. Kryesuesit e tanishëm të Superligës, pas disa barazimeve radhazi, në vend të Sulejman Starovës, e rikthyen Zekirija Ramadanin. Ndryshime bëri edhe kampionia e Kosovës, Drita e Gjilanit, e cila trajnerin që e udhëhoqi drejt titullit kampion dhe prezantimit që i bëri në arenën ndërkombëtare, Bekim Isufin, e zëvendësoi me trajnerin

nga Shqipëria, Shpëtim Duron. Ky i fundit doli të jetë shpëtimtar i madh i gjilanasve, pasi i ka ngritur në pozitën e tretë në tabelë.

Shkarkimi më i madh ishte ai i Bylbyl Sokolit nga Llapi. "Profia" pak kohë punoi i qetë si trajner i Llapit, pasi disa herë u fol për largimin e tij, por edhe raportet e tij me drejtorin sportiv, Tahir Batatina, asnjëherë nuk ishin të mira. Ende vazhdojnë përplasjet nëpërmjet deklaratave në mes të Sokolit dhe Batatinës. Vendin e

"Profës" e zuri Bekim Shotani që nuk pati paraqitje të mira me skuadrën e Ballkanit në Superligë. Shotani fillimisht u nda me skuadrën nga Suhareka dhe më pas mori drejtimin e Llapit. Dorëheqja e fundit ka ardhur nga trajneri Gugash Magani, i cili, pas humbjes nga Prishtina të mërkurën (2-0), e zyrtarizoi ndarjen me Trepçën '89. Trajneri shqiptar ka thënë se po largohet nga '89-shi për shkak se skuadra nga Mitrovica është larg objektivit që kishte në fillim të kampi-

Veseli: FFK-ja të marrë në përkujdesje stadiumet 'Fadil Vokrri' dhe 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka marrë përkrahjen e plotë nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ky i fundit i ka pritur në një takim të enjten drejtuesit e FFK-së në krye me kryetarin Agim Ademi, sekretarin e përgjithshëm Eroll Salihu dhe ndihmëstrajnerin e Përfaqësueses A, Muharrem Sahiti.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, e ka përgëzuar kryetarin Ademi dhe FFK-në për punën e palodhshme që po bëjnë, duke thënë se institucionet e Republikës së Kosovës do të jenë në mbështetje të tyre. Ai i ka inkurajuar drejtuesit e FFK-së që



të marrin nën përkujdesje stadiumin "Fadil Vokrri" dhe atë olimpiq "Adem Jashari" në

Mitrovicë si dhe të shikohet mundësia që të ndërtohet një qendër kamping-stërvitor në

Blinajë që ofron kushte të jashtëzakonshme për punë dhe vendosjen e ekipeve përfaqësuese, duke premtuar se do të jetë mbështetës i fuqishëm i çdo lloje iniciative që shkon në të mirë të zhvillimit të futbollit. "Shteti ka obligim ta përkrahë sportin, me këtë rast futbollin, sepse konsideron se janë ambasadorët më të mirë e të denjë të vendit. Unë do të jem përkrahës i fuqishëm juaji", ka thënë Veseli.

Ndërsa kryetari Ademi e falënderoi kryetarin e Kuvendit, Kadri Veselin, për mbështetjen e madhe, kurse e njoftoi edhe për zhvillimin e futbollit, për ecurinë e ekipeve përfaqësuese në arenën

ndërkombëtare. Numri një i futbollit e njoftoi kryeparlamentarin Veseli edhe për infrastrukturën në përgjithësi dhe se FFK-ja gati i ka në përfundim 6 fusha të futbollit me bari artificial dhe me 6 tjera që do t'i ndërtojë MKRS-ja. "12 skuadrat e IPKO Superligës do të kenë kushte më të mira për punë si dhe do të zbutet shumë çështja e infrastrukturës. Kemi edhe përkrahjen e UEFA-s dhe FIFA-s për ndërtimin e qendrës stërvitore të ekipeve përfaqësuese. Do të punojmë edhe për ndërtimin e selisë së FFK-së tashmë që e kemi në pronësi lokacionin, që pa ndihmën tuaj si kryeparlamentar do të ishte e pamundur", ka thënë Ademi.

U17-shtat e Kosovës kalojnë në raundin elitare

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll ka arritur sukses his-

torik, duke u kualifikuar në rrethin elitare për kualifikimet e Evropianit 2019. Në ndeshjen e

tretë kundër Qipros, djelmoshat e drejtuar nga trajneri Besnik Kollarit shënuan fitore

me rezultat 1-0. Golin e vetëm në ndeshje e shënoi Milot Avdyli në minutën e 63-të.

Kosova tani ka 6 pikë në pozitën e parë, një më shumë se Skocia në pozitën e dytë.

Mysafirët fitojnë në elitën e hendbollit

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Pas aktiviteve të shumta ndërkombëtare, ndeshjeve të Kombëtares A me Poloninë e Gjermaninë, miqësoret e kombëtares së femrave në Luksemburg dhe ngjarjes shumë peshë, "IHF Trophy"

që u mbajt në Prishtinë, janë rikthyer garat në Superligën e hendbollistëve. Janë luajtur tri ndeshje të mbetura të javës së pestë, që janë shtyrë për shkak të aktiviteve ndërkombëtare. Ashtu si pritej, fitore kanë shënuar

skuadrat mysafire, që edhe ishin favorite të mëdha. Drita e Gjilanit e ka shënuar edhe fitoren e pestë rresht, duke fituar thellë ndaj Trepçës në Mitrovicë me rezultat 32:20. Fitoren e pestë e shënoi edhe Kastrioti, që fitoi ndaj Zhegrës

në Gjilan me rezultat 46:21. Ndërkohë Prishtina fitoi ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat 40:22. Në tabelë udhëheqin Kastrioti, Besa Famgas e Drita me nga 10 pikë, ndërsa Prishtina është e katërta me tetë pikë.



Distria dhe Erza synojnë sukseset në Tokio

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Në mesin e xhudistëve që po arrijnë suksese në garat ndërkombëtare është edhe Distria Krasniqi, e cila po synon që Kosovës t'i sjellë medalje nga Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Krasniqi, e cila tashmë po bëhet gati për këto lojëra, thotë se tashmë është adaptuar në kategorinë 48 kilogramë dhe ka arritur pikët e nevojshme për pjesëmarrje. "Është hera e parë që kam arritur të shkoj në finale në një 'Grand Slam'. Dihet tash që 'Grand Slam' dhe 'Grand Prix' në xhudo janë shumë të forta pasi që ka filluar të bëhet kualifikimi edhe mbledhja e pikëve për t'u kualifikuar për Tokio. Kështu që unë kam mbledhur pikët për Tokio.



Shpresoj të kualifikohem atje dhe të kthehem me medalje", ka thënë Krasniqi. Kurse xhudistja Erza Muminović, e cila mori pjesë në Lojërat Olimpikë për të rinj në Argentinë, ka thënë se, pavarësisht prej lojërave të ashpra, ajo arriti t'i sjellë Kosovës medalje. Njëherësh, Erza njoftoi që synimi i saj i ardhshëm është pjesëmarrja në Lojërat Olimpikë për të rritur.

"Normalisht ka qenë e vështirë pasi që të gjitha luftërat kanë qenë të ashpra derisa në fund arrita të fitoj medalje. Normalisht në kategorinë time kam qenë favorite kur të gjithë kanë pritur medalje nga unë, kemi pritur edhe të artën, por medalja është medalje, nuk ka rëndësi", ka thënë Muminović. Përndryshe, së fundmi në garat e Grand Slamit në Abu Dhabi Kosova fitoi katër medalje, ndër të cilat Nora Gjakova fitoi një medalje të artë, kurse Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova fituan medalje të argjendta. Ndërsa në Lojërat Olimpikë për të Rinj që u mbajtën në Argentinë, xhudistja Erza Muminović i solli Kosovës medalje të bronzë.

'Epoka e re' - 'Lajmi.net', derbi i Media Ligës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Sot (e premte) zhvillohen ndeshjet e xhiron së tetë në Media Ligë. Ndeshja kryesore do të jetë ajo në mes të lideres së ligës, "Epokës së re" dhe "Lajmi.net". Derisa "Epoka" nuk di për humbje në këtë edicion, "Lajmi.net" pësoi humbje në xhiron e kaluar nga "Telegrafi" dhe tash renditet në pozitën e katërt në tabelë. Synimet e "Epokës" nuk ndryshojnë as në



këtë ndeshje, derisa "Lajmi.net" do të mundohet t'i njoftojë me humbje kryesuesit e ligës. Ndeshje interesante do të jenë edhe "Media Works" -

JAVA E TETË

17:00 "D+" - "Kallxo.com"
17:55 "Gazeta Zëri" - "Ora Info"
18:50 "Infokusi" - "Gazeta Blic"
19:35 "Epoka e re" - "Lajmi.net"
20:30 "KosovaPress" - "InfoKosova & PrishtinaPost"
21:15 "Media Works" - "RTV Dukagjini"
22:10 "Gazeta Metro" - "Klan Kosova"
23:05 "Telegrafi" - "RTK"

"RTV Dukagjini" dhe "Gazeta Metro" - "Klan Kosova".

LeBron ua jep fitoren lakersave

LOS ANELES, 1 NËNTOR - Golden State ka marrë kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 131-121 ndaj New Orleansit, suksesi i gjashtë radhazi për kampionët në fuqi të NBA-së. Një takim që u dominua nga vendësit, me Curryn që realizoi 37 pikë, mbështetur edhe nga Duranti me 24. Fitore në sekondat e fundit korri skuadra e Lakersit, që mundi 114-113 Dallasin, ndeshje që u vendos nga një gjuajtje e lirë e LeBron Jamesit (29 pikë). Të pestë titullarët e ekipit kalifornian realizuan mbi 12 pikë, ndërsa për Mavericksin u dallua Matthews me 21 pikë, por që mbetën për statistikë. Dy ndeshje të luajtura sot u vendosën pas kohës shtesë. Brooklyn mposhti 120-119 Detroitin, një sfidë me rivalitet deri në fund, ku u dallua Dinwiddie me 25 pikë, që e nisi



